

**KONTRATË  
SHITJE KUOTASH**

Sot më datë **28.06.2024**

**Bjona Ziaj**, i ditëlindjes 16.12.1989, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plota për të vepruar, mbajtës i ID me nr. Personal I96216052F (në vijim referuar si Blerësi)

Dhe

**Erinda Xhaferaj** i ditëlindjes 16.06.1989, lindur në Skrapar dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plota për të vepruar, mbajtës i ID me nr. Personal I95616062W (në vijim referuar si "Shitësi")

Individualisht referuar edhe si Palë dhe bashkërisht edhe si Palët.

**DISPOZITA PARAPRAKE:**

Meqenëse:

- a. Shitësi është Ortak me pjesëmarrje 50% të kuotave (Kuotat Target), të kapitalit të "EBCons" sh.p.k. me NUIS M41319025P, shoqëri e regjistruar në 19.01.2024, me seli qendrore në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Pallati 7/1, Hyrja 2, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori Bjona Ziaj;
- b. "EBCons" sh.p.k. ka si objekt kryesor: Aktivitetet në fushën e konsulencës financiare, fiskale dhe manaxheriale; Ngritura, përmirësimi dhe strukturimi i shoqërive operuese në industri të ndryshme; Ngritura, përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemeve kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike si dhe trajnimin profesional të personelit që është ngarkuar me funksionimin e këtyre sistemave; Përgatitja e raporteve periodike financiare sipas nevojave të drejtuesve të biznesit; Përgatitja e planeve të biznesit për nevojat e drejtuesve dhe për palët e treta, rivlerësim aktivitetesh, këshillime biznesi mbi mundësitë e zhvillimit, këshillime për fillim aktiviteti tregtar; Organizimi i kurseve të trajnimit profesional në fushën e kontabilitetit, financës e të administrimit financiar; Konsulenca në lidhje me transformimet dixhitale të proceseve të shoqërive operuese në

indsutri të ndryshme; Konsulencë me donatorët e huaj; Çdo aktivitet tjetër të lidhur me sa më sipër dhe në përputhje me legjislacionet përkatëse.

- c. Shitësi dëshiron të shesi dhe Blerësi dëshiron të blejë kuotat e "EBCons" sh.p.k.

Në përputhje me sa më sipër, palët, bazuar në nenin 73/1/b të Ligjit nr.9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" - i ndryshuar, nenin 705 dhe vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar, në përputhje me Statutet dhe Vendimet e asambleve, në përputhjë me autorizimet e velfshme ligjërisht, nënshkruhet kjo kontratë, me përbajtjen si vijon:

#### **Neni 1**

##### **Objekti i kontratës**

- 2.1. Objekti i kësaj kontrate është shitja prej Shitësit të Kuotave Tagrget tek Blerësi, e cila përfaqëson 50% (**pesëdhjetë përqind**) të kapitalit të "EB Cons" sh.p.k., kundrejt Çmimit të shitjes që do të paguhet nga Blerësi.
- 2.2. Shitësi/Ortaku Erinda Xhaferraj, shet kundrejt Blerësit, kuotën e zotëruar prej saj në shoqëri, e cila përfaqëson 50% të kapitalit.
- 2.3. Kuotat Target janë të lira pér tu shitur, nuk kanë asnje barrë apo penagesë ligjore pér transferimin lirisht nga Shitësi tek Blerësi.

#### **Neni 2**

##### **Çmimi i shitjes**

Çmimi i shitjes, është 5,000 lekë (**pesë mijë lekë**), vlerë e cila do të likujdohet nga Shitësi tek Blerësi. Ky çmim është i njëjtë me vlerën e kapitalit.

#### **Neni 3**

##### **Mënyra e pagesës dhe kalimi i pronësisë**

- 3.1. Çmimi i shitjes i përcaktuar në nenin 2, do të likujdohet nëpërmjet pagesave nga kanalet bankare deri në 180 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi deklaron se nuk ka asnje kundështim apo kërkesë pér pagesa shtesë nga Blerësi.
- 3.2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësi është pronar i kuotave target dhe shndërrohet në pronar me të drejta të plota të një kuote që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë "EBCons" sh.p.k.

#### **Neni 4**

### **Të drejta e detyrime të palëve**

4.1. Shitësi garanton se kuota target, objekt kontrate është lirisht e transferueshme dhe se ai është i vetmi pronar e gjzon të drejta të plota mbi kuotën.

4.2. Shitësi pranon që çmimi i cituar në nenin 2 të kësaj kontrate, është çmimi i vetëm dhe përfundimtar në lidhje me shitjen e kuotave target (50% të kapitalit) të "EBCons" sh.p.k.

4.3. Shitësi pranon se mënyra e pagimit të çmimit është mënyra e vetme dhe përfundimtare dhe se ai nuk do të këtë asnjë pretendim vijues të çdo natyre në lidhje me këtë.

4.4. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotën target (kapitalin) objekt të kësaj kontrate dhe cdo të drejtë mbi EBCons Shpk., pronësi e cila me nënshkrimin e kësaj kontrate, i kalon Blerësit, ashtu sikurse edhe çdo e drejtë apo përfitim tjetër i lidhur me të, përfshirë edhe të drejtën e Blerësit për të përfituar çdo dividend të maturuar, të deklaruar apo aprovuar deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

4.5. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësi, pranon dhe merr përsipër të gjitha detyrimet që lindin duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

4.6. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësit zhvishen nga e drejta e pronësisë dhe nuk do të jenë më në cilësinë e ortakëve të shoqërisë.

### **Neni 5**

#### **Të ndryshme**

5.2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, palët bien dakord që çdo e drejtë apo detyrim i pasqyruar në pasqyrat e fundit financiare të publikuara të shoqërisë, qëndrojnë meblerësin dhe shitësi heq dorë prej tyre.

5.3. Në rast mospërputhje midis kësaj kontrate dhe marrëveshjeve të veçanta (nëse ka ose do të ketë të tillë), do të prevalojë parashikimi i marrëveshjes së veçantë, e nëse ka konflikt midis marrëveshjeve të veçanta, do të prevalojë rregullimi më i vonë.

5.4. Pavlefshmëria e një a më shumë dispozitave të kësaj kontrate nuk e bën atë të pavlefshme në tërësi. Në një rast të tillë, kur evidentohet se një a më shumë dispozita të kësaj kontrate janë ose bëhen të pavlefshme, palët do të zëvendësojnë dispozitën/at e pavlefshme me të vlefshme të cilat i afrohen sa më shumë qëllimit të palëve të shprehur përmes dispozitave që janë ose bëhen të pavlefshme.


**Neni 6**

**Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi**

- 6.1. Kjo kontratë përgatitet në 3 kopje të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës, ndërkokë që një kopje do t'i njoftohet dhe do të aplikohet pranë regjistrat tregtar.
- 6.2. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.


**SHITËSI**

ERINDA XHAFFERRAJ

  
[emër, mbiemër, firmë ]

**BLERËSI**

BJONA ZIAJ

  
[emër, mbiemër, firmë ]